



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 312/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Dardanë, paraqitur kundër subjektit politik Partia e Drejtësisë (PD), dega në Dardanë, për shkak të vendosjes së posterëve mbi shenjat të komunikacionit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Dardanë subjektit politik Partia e Drejtësisë (PD), dega në Dardanë i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1000 (njëmijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 22.10.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën pretendohet se me datën 21.10.2013, në Rrugën “Skënderbeu” në Dardanë rreth orës 14:00, anëtarë të subjektit politik PD, kanë vendosur posterat mbi shenjat e komunikacionit, ku me këtë veprim sipas parashtrësit të ankesës janë shkelur dispozitat ligjore mbi Zgjedhjet Lokale, neni 33 pika b) e LZP, dhe neni 4.1 dhe pika b) e Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Parashtrësi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografi..

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PD, me datën 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PD, në të cilën theksohet se vendosja e posterave të kandidatit ton në Dardanë është një montim i organizuar nga ndonjë subjekt tjetër dhe assesi nga anëtarët apo simpatizantët të partisë së tyre. Ata shtuan se PD-ja ka marrë të gjitha masat e nevojshme që degët e saj të mos i shkelin rregullat zgjedhore, respektivisht kanë trajnuar dhe vetëdijesuar aktivistët e tyre për respektimin e rregullave zgjedhore, dhe se jemi të gatshëm të marrim përgjegjësit tona në momentin kur vërtetoj se aktivistët tan kanë bërë shkeljet zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës se subjekti politik PD ka vendosur posterat në shenjat të komunikacionit publik në rrugën Rrugën “Skënderbeut” në Dardan, janë të qëndrueshme ngase konstatohen nga fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti i njëjtë politik ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se subjekti politik PD, është hera e parë që ka bërë shkelje të kësaj natyre në këto Zgjedhje Lokale.

Andaj, PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se subjekti politik PD, ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që postera të PD-së janë vendosur mbi shenjat e komunikacionit dhe se PD nuk ka bërë përpjekje për evitimin e shkeljeve të supozuar në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 312/2013 më datën 25.10.2013.



Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelimi, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*